



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:125152

Datë: 21.09.2020

Numri i dokumentit: 01127405

C.nr.73/18

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil si gjykatë civile e shkallës së parë, me gjyqtarin Veton Ademaj, në çështjen juridike – kontestimore te paditësit: Z U nga fshati B Komuna e Pejës, të cilin e përfaqëson avokat Fisnik Mujaj me autorizim, kundër të paditues Komuna e Pejës -DA, të cilën e përfaqëson Fisnik Imami me autorizim, për kompensimin e pagave jubilarë dhe percjellese, vlera e kontestit 2,657.60 €, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor në prezencë të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarit të paditues me datë 15.09.2020, ndërsa me datë 17.09.2020, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Z U nga fshati Baran K-Pejë, ashtu që **DETYROHET** e paditura Komuna e Pejës -DA, që paditësit Z U nga fshati B K-Pejë, në emër të shpërblimit jubilar t'ia kompensoj shumën e tri neto pagave bazë në shumën prej 1.215.00 euro dhe në emër të shpërblimit për percjellje në pension shuma e tri neto pagave të fundit në shumën prej 1442.60 euro, e që në total i bie shuma prej 2.657.60 euro.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Pejës -DA, që paditësit shumën e cekur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguaj me kamatë ligjore prej 8 % në vitë, e cila do t'iu llogaritet nga data e marrjes së këtij aktgjykimi datë 17.09.2020, si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 743 Euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi Z U nga fshati B K-Pejë ka parashtruar padinë për kompensimin e pagave për percjellje në pension dhe shpërblimi jubilar me datë 24.01.2018, me të cilën ka kërkuar që në emër të tri pagave percjellese me rastin e pensionit me dt. 26.01.2017 të paguaj shumën prej 1215 euro dhe në emër të tri pagave jubilarë nga përvoja e punës të paguaj shumën prej 1012 euro, duke përfshirë shumën e cekur me lartë arrin shumën e përgjithshme prej 2227 euro, si dhe kamaten ligjore prej 8% duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive.

E autorizuar e të paditues me datë 04.12.2019 ka paraqitur përgjigje në padi me të cilën ka kërkuar që padia dhe kërkesë padia e paditësit të refuzohet si e pabazuar duke theksuar se pala

e paditur nuk e ka obligim te pageses prej tri pagave për percjellje ne pension dhe pagave për shperblim jubilar sepse te paditurit i mungon legjitimitetit real pasiv dhe sene asnje dokument ligjor nuke shte nenshkruese e paditura ketu Komuna e Pejës. Njeherit kërkon nga paditesi qe kerkes padine tia drejtoj Ministrise së Arsimit (MASHT) dhe Ministrise se Financave (MF-së) si garantues per permbushjen e obligimeve financiare qe rrjedhin nga Kontrata kolektve e dates 18.04.2017 për punetoret e arsimit parauniversitar te cilën e kane nenshkruar MASHT-i dhe SBASHK-u.

Paditesi gjatë shqyrtimit kryesor, dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se Mbesim ne tërësi pranë padisë dhe kërkesës se saj, konfirmoj se kam pranuar ekspertizen financiare si dhe plotësimin e ekspertizës financiare, e në harmoni te se cilës e kam bere precizimin e kërkesëpadisë me parashtresën e dt. 07.08.2020, po ashtu në këtë seance e beje edhe njëherë precizimin e kërkesëpadisë sa i përketë shpërblimeve jubilarë, andaj për shpërblime jubilarë e kërkojmë shumën 1215 euro, që i bie nga 405 euro në bazë të pagës bazë për secilën nga 3 shpërblimet jubilarë, e që shuma e përgjithshme ne emër te pagave përcjellëse ne pension dhe shpërblimeve jubilarë 2657.60 euro, e ky precizim ne këtë seancë llogaritet si pjesë përbërëse e parashtresës së dt. 07.08.2020, paditësit i takon e drejta ne tri paga përcjellëse ne pension dhe 3 shpërblime jubilarë ne baze te Kontratës Kolektive të Arsimit së viti 2014. Shpenzimet e procedurës i kërkojmë dhe atë për taksë gjyqësore shumen prej 30 euro për përpilimin e padisë shumen prej 104 euro, për tri seanca të mbajtura nga 135 euro $3 \times 135 = 405$ euro, për ekspertizë financiare shumën prej 100 euro, dhe parashtresës mbi precizimin e kërkesë padisë shumen 104 euro, apo në shumë totale 743 euro.

E autorizuar e të paditurës gjatë shqyrtimit kryesor dhe ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e kundërshtoj precizimin e padisë nga ana e paditësit të dhënë ne seancën e sotme si dhe parashtresën e dt. 07.08.2020, e gjithashtu mbesim ne tërësi pranë thënieve ne përgjigje ne padi, dëshirojmë te theksojmë se pretendimet e paditësit se i padituri ka obligim te pagesës prej 3 pagave përcjellëse dhe për shpërblim jubilar nuk qëndrojnë sepse te paditurit i mungon legjitimiteti real pasiv ne këtë procedurë dhe realisht paditesi padinë për pagesën e pagave përcjellëseve dhe te shpërblimeve jubilarë është dashur te ia drejtoj Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Financave, si garantuese e përmbushjes se obligimeve financiare lidhur me te drejtat që rrjedhin nga marrëveshja e përgjithshme kolektive e viti 2014 të nënshkruar në mes të Odës Ekonomike të Kosovës, Aleancës Kosovare të Biznesit, BSPK-së dhe Qeverise se Kosovës – MPMS, ku kjo kontratë e obligon Ministrinë e Arsimit dhe SBASHK-un që të beje sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për komunat e Kosovës me qellim të realizimit të buxhetit të nevojshëm për përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga kjo kontrata, pra obligimi ligjor i bie Ministrisë se Arsimit dhe nënshkrueseve te kësaj kontrate, e kurrresi të paditurit Komuna e Pejës, pasi që Komuna e Pejës nuk është nënshkruese e kësaj kontrate. Sa i përketë ekspertizës nuk e kundërshtojmë. Sa i përketë kërkesës për pagën jubilarë konsiderojmë se një kërkesë e tille është parashkruar dhe kjo kërkesë nuk mund të realizohet pas pensionimit në mënyrë retroaktive.

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike sipas propozimit te paleve gjykata ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar këto prova: Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU ‘Dëshmorët e kombit’ fsh. B, me nr. te protokollit 11017 e dt. 13.12.2017, Kontrata e punës e

lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës me nr. 11/47 e dt. 07.04.2015, Kërkesa e paditësit e dt. 13.12.2017 drejtuar Komunës së Pejës- Drejtoria e Arsimit, Përgjigja në kërkesën e paditësit e lëshuar me dt. 20.12.2017, me nr. 2304/115 lëshuar nga Komuna e Pejës – DA Aktvendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës sipas fuqisë ligjore për paditësin i dt. 27.12.2016, me nr. 4033/165, i lëshuar nga Komuna e Pejës- DA, Letërnjoftimi i paditësit me nr. personal ..., Ekspertiza financiare e punuar nga eksperti financiar gjyqësorë Gani Gashi e dt. 12.03.2020, Plotësimi i ekspertizës financiare i dt. 29.07.2020 i punuar nga eksperti financiar gjyqësorë Gani Gashi, gjykata me rastin e vendosjes mori parasysh edhe deklaratimet e të autorizuarve të ndërgjyqësve.

Gjykata pas vlerësimit të secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku në lidhmëri me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga Vërtetimi i lëshuar nga SHFMU ‘Dëshmorët e kombit’ fsh. B, me nr. të protokollit 11017 e dt. 13.12.2017 vërtetohet se paditësi Z U ka qene i punësuar ne shkollën e mesme e ulet “Deshmoret e kombit” ne fsh. B K- Pejë dhe ka 42 vite e 2 muaj përvoj pune.

Nga Kontrata e punës e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës me nr. 11/47 e dt. 07.04.2015, vërtetohet fakti se paditësi Z U me date 01.09.2014 ka lidhur kontratë pune me të paditurën këtu Komunën e Pejës – DA, ku ka qene i punësuar si mësimdhënës ne SH.F.M.U. “Deshmoret e Kombit”, ne fshatin B K- Pejë.

Nga Kërkesa e paditësit e dt. 13.12.2017 drejtuar Komunës së Pejës- DA, vertetohet fakti se paditësi i eshte drejtuar pales se paditur- Komunes se Pejes- Drejtoratit Komunal te Arsimit për kompensimin e tri pagave jubilarë nga pervoja e punes dhe tri pagave me rastin e pensionimit.

Nga Përgjigja në kërkesën e paditësit e lëshuar me dt. 20.12.2017, me nr. 2304/115 lëshuar nga Komuna e Pejës – Drejtoria e Arsimit, është vërtetuar se paditësi Z U nuk mund ti aprovoj kete kerkese për arsye se Ministria e Financave nuk ka bere alokimin e mjeteve financiare apo te ndonje granti te posaqem per realizimin e kesaj te drejte.

Nga Aktvendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës sipas fuqisë ligjore për paditësin i dt. 27.12.2016, me nr. 4033/165, i lëshuar nga Komuna e Pejës- DA, vërtetohet fakti paditësit Z U i ndërprehet marrëdhënia e punës sipas fuqisë ligjore në vendin e punës mësimdhënës në shkollën fillore të mesme ulët “Deshmoret e Kombit” ne fshatin B K-Pejë, me dt. 26.01.2017 për shkak të mbushjes së moshës mandatorë të pensionimit që është gjashtëdhjetë e pese (65) vjeç.

E paditura nuk kishte kontestuar lartësinë e viteve të përvojës së punës së paditësit, gjithashtu nuk ishte kontestuese së paditësi ka qenë i punësuar në shkollën fillore “Deshmmoret e Kombit” në B, mirëpo kontestuese ishte baza juridike e kërkesë padisë, sa i përketë pagave jubilarë.

Gjykata gjenë së baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit gjenë në mbështetje në dispozitat ligjore si në vijim:

Në nenin 4, par.2 të Ligjit të Punës (Nr.03/L-212) i cili ka qenë në fuqi në kohën e pensionimit të paditësit, gjithashtu edhe tani është në fuqi, parashihet se “Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”. Ndërsa në nenin 67 të këtij ligji parashihet se “1.Kontrata e punës sipas fuqisë ligjore ndërpritet: 1.4. **kur i punësuarin e mbush moshën e pensionimit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeq**”. Po ashtu në nenin 90 të këtij ligji parashihet se “1. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet:1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në:2.1. nivel të vendit,2.2. nivel të degës,2.3. nivel të ndërmarrjes.3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuara në këtë ligj”.

Gjithashtu, në nenin 36, **paragrafi 9**, te Kontratës Kolektive te Arsimit para Universitar te lidhur ne mes të Ministrisë se Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës se Bashkuar te Arsimit shkencës dhe Kulturës se Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015, parashihet : “ Punëtorët (Anëtarët e SBASHK-ut) qe dalin ne pension përfitojnë shpërblimin jubilar ne vlere. Nen paragrafin **9.1** i cili parasheh “për 10 vjet te përvojës se punës tek punëdhënësi i fundit ne vlere te një page baze; nen paragrafi **9.2** i cili parasheh “ për 20 vjet te përvojës se punës tek punëdhënësi i fundit ne vlere te dy pagave baze; nen paragrafi **9.3** i cili parasheh “ për 30 vjet te përvojës se punës tek punëdhënësi i fundit ne vlere te tri pagave baze; nen paragrafi **9.4** i cili parasheh ” Punëdhënësi i fundit është ai qe paguan shpërblimin jubilar; dhe nene paragrafi **9.5** i cili parasheh “Shpërblimin jubilar paguhet ne afat prej një muaji pas plotësimit te kushteve”. Gjithashtu edhe neni 10 i kësaj kontrate parasheh se “Punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) qe dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse ne lartësi të tri pagave sipas mesatares se tri pagave të fundit të punëtorit.

Me qëllim të vërtetimit të lartësisë së kërkesë padisë, sipas detyrës zyrtare gjykata ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare e cila është punuar nga eksperti financiar gjyqësor Gani Gashi, të punuar me datë 12.03.2020, e të plotësuar me date 07.08.2020 ku nga Ekspertiza e tillë financiare, është vërtetuar për paditësin Z U, lartësia e shumës për pagat jubilarë dhe për tri pagat përcjellese pas pensionimit dhe ate në emër të shpërblimit jubilar t’ia kompensoj shumën e tri neto pagave baze në shumën prej 1.442.60.00 euro (mirëpo paditësi e ka zvogëluar kërkesën në emër të kompensimit për paga jubilar në shumën 1215 euro) dhe ne emër të shpërblimit për përcjellje në pension shuma e tri neto pagave te fundit në shumën prej 1442.60 euro, e që në total i bie shuma prej 2657.60 euro.

Në mes palëve ndërgjyqësve nuk ishte kontestuese se paditësi tek e paditura kanë qenë në marrëdhënie pune, të caktuar në vendin e punës – sipas kontratave te punës me DKA ne Pejë, apo te vërtetimeve te lëshuara nga shkollat në të cilat kanë punuar paditësit, të njëjtët i është

ndërprerë marrëdhënia e punës, për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare (pensionimit).

Po ashtu edhe pretendimet e palës se paditur se kontrata në të cilën janë thirr pala paditëse nuk prodhon efekte juridike dhe se kërkesa e palës paditëse për kërkimin e pagesave të pagave jubilarë është parashkruar, një gjë e tillë nuk qëndron sepse kjo kontratë (Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar) ka qenë në fuqi nga data 01.01.2015 deri me 18.04.2017, andaj pasi që kjo kontratë ka qenë e zbatueshme gjatë kësaj kohë dhe duke marrë parasysh kohën kur paditësi është pensionuar, i cili është pensionuar brenda kësaj periudhe kohore sa ka qenë në fuqi kjo kontratë, andaj gjykata duke pasur parasysh rrethanën e lartcekur, gjeti se kundërshtimi i të paditurës është i pabazuar.

Gjithashtu edhe pretendimi i të paditurës së kërkesa për pagesën e pagave jubilarë është parashkruar në afatin prej 3 viteve, gjykata nuk e mori parasysh për shkak se në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar të nënshkruar nga MASHT-i, dhe SBASHK-u, me datë 11.04.2014, e cila ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015, ku në nenin 36 paragrafi 9 është cekur : “ Punëtorët (Anëtarët e SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë. Nen paragrafin **9.1** i cili parasheh “për 10 vjet të përvojës së punës tek punëdhënësi i fundit në vlerë të një page baze; nen paragrafi **9.2** i cili parasheh “ për 20 vjet të përvojës së punës tek punëdhënësi i fundit në vlerë të dy pagave baze; nen paragrafi **9.3** i cili parasheh “ për 30 vjet të përvojës së punës tek punëdhënësi i fundit në vlerë të tri pagave baze; nen paragrafi **9.4** i cili parasheh ” Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblimin jubilar; dhe nene paragrafi **9.5** i cili parasheh “Shpërblimin jubilar paguhet në afat prej një muaji pas plotësimit të kushteve”. Gjithashtu edhe neni 10 i kësaj kontrate parasheh se “Punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit. Andaj, në këtë rast ka lindur detyrimi i të paditurës që në cilësi të punëdhënësit të fundit, që paditësit të lartcekur t’ia paguaj pagat jubilarë dhe përcjellëse.

Ligji i punës (Nr.03/L-212) në nenin 87 parasheh “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, andaj në kuptim të kësaj dispozitë ligjore gjykata gjenë së pretendimi i të paditurës së kërkesat nga marrëdhënia e punës parashkruhen brenda afatit prej 3 viteve, është i pabazuar, sepse gjykata duke pasur parasysh se që nga momenti i pensionimit të paditësit, si dhe data e paraqitjes së kërkesës së paditësit për kompensimin e paga përcjellëse dhe jubilarë të paraqitura të e paditura me datë 13.12.2017, e deri të parashtrimit i padisë në gjykatë me datë 24.01.2018, nuk kanë kaluar 3 vite.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadija e paditësit duhet të aprovohet si e bazuar. Kjo ngase në bazë të provave të administruara është vërtetuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, kur të njëjtit me vendim të të paditurës ju është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionit. Pasi që paditësi në procedurë administrative nga e paditura nuk ju është dhënë kompensimi i pagave përcjellëse dhe pagave jubilarë me rastin e shkuarjes në pension, andaj i njëjti ka kërkuar realizimin kompensimit të pagave përcjellëse dhe jubilarë në procedurë gjyqësore, çka një e drejtë e tillë

ishte e argumentuar dhe e bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar të nënshkruar nga MASHT-i, dhe SBASHK-u, me datë 11.04.2014, e cila ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015, andaj gjykata e detyroi të paditurën, që paditësit t'ia paguajë pagat në emër të shpërblimit jubilar sipas përvojës së punës që ka arritur deri në momentin e pensionimit, si dhe pagat për përcjellje në pension, në lartësi të tri pagave të fundit të cilat i kanë realizuar këtu paditësi, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë mori parasysh ekspertizën financiare të punuar nga eksperti financiar-gjyqësor dhe të njëjtës ia fali besimin në tërësi, pasi që ishte në harmoni edhe me provat e tjera në shkresat e lëndës, gjithashtu edhe provave tjera të lartcekura gjykata ua fali besimin e plotë, ngase gjeti se të njëjtat janë të besueshme dhe përputhen në tërësi me gjendjen faktike të vërtetuar, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe kundërshtimet e tjera të palës së paditur, mirëpo të njëjtat ishin pa ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridiko-kontestimore.

Në lidhje me kamatën ligjore gjykata nuk e aprovoi kërkesën e palës paditëse që kamata ligjore të paguhet nga data e paraqitjes së padisë e që është data 24.01.2018, mirëpo vendosi që e paditura duhet ta paguaj kamatën për kompensimin për pagat përcjellëse dhe jubilarë, si në pikën II të dispozitivit, pasi që gjykata ka vlerësuar se kamata rrjedh nga data e marrjes së këtij aktgjykimi, e që në rastin konkret është data 17.09.2020, kjo bazuar në nenin 382 parag.1 dhe 2 të LMD-së, pasi që pala e paditur nga data e marrjes së këtij aktgjykimi është në dijeni për lartësinë e kompensimit në emër të pagave përcjellëse dhe jubilarë të paditësit dhe e njëjta nga data e lartcekur bie në vonesë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449, 452, 453.1 dhe 463 të LPK-së si dhe duke u bazuar në Tarifën e OAK-së, ku është obliguar pala e paditur që paditësit t'ia paguajë shumën prej 739 Euro, për shpenzimet gjyqësore dhe atë: për taksën për padi 30 euro, shpenzimet e përpilimit të ekspertizës financiare ne shume prej 100 euro, perpilimin e padise shumen prej 104 euro per tri seanca te mbajtura 3X135=405 euro.

Nga të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr. 73/18, datë. 17.09.2020

G J Y Q T A R I

Veton Ademaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes se te njëjtit, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.